

Autore: Blerina Këllezi, Aurora Guxholli

Titulli: Pasojat e krimeve të komunizmit dhe rëndësia e reformave ekonomike në drejtësinë tranzitore

Krimet e diktatures komuniste në Shqipëri përfshinë shkeljen e të drejtave civile dhe politike si dhe të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore. Pasojat e këtyre krimeve shtrihen në breza dhe janë të pranishme edhe sot, mbi 30 vjet pas rënies së regjimit komunist. Ky studim synon të hedhë dritë mbi perceptimet e të mbijetuarve të krimeve të diktatures dhe pasardhesve të tyre mbi zhvillimet e drejtësisë tranzitore në Shqipëri. Ai bazohet në ndërthurjen e metodologjisë cilësore (27 intervista) me atë sasiore (130 pyetësorë). Analiza e të dhënave tregoi se të mbijetuarit e krimeve komuniste dhe pasardhesit e tyre vlerësojnë dëmshpërblimin ekonomik si një nga aspektet më të rëndësishme të drejtësisë tranzitore. Sipas tyre, dëmshpërblimi për krimet e kryera duhet të ketë një natyrë të gjërë dhe të përfshijë pasojat që vijuan nga shkeljet e të drejtave civile dhe politike si dhe të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore: humbjet e familjarëve, kohëqëndrimin dhe punën në burg, mohimin e të drejtës së arsimimit, pensioneve, banimit, kujdesit shëndetësor, sekuestrimin e pronës si dhe pjesëmarrjen në jetën familjare, politike, sociale dhe kulturore.

Fjalet kyçe: Drejtësia tranzitore, reforma ekonomike, reparacioni, perceptimet e të mbijetuarve

Title: The consequences of communist crimes and the importance of economic reforms in transitional justice.

The crimes of the Albanian communist regime included the violation of civil and political rights as well as economic, social and cultural rights. The consequences of these crimes extended to several generations and are present even today, over 30 years since the end of the communist regime. This study aims to document the accounts of the survivors and their descendants on the developments and impact of existing transitional justice mechanisms in Albania. The study combines qualitative approaches (27 interviews) with quantitative approaches (130 surveys). The analysis of the data shows that the survivors of the dictatorship and their descendants believe that economic compensation (and redress) are one of the most important mechanisms of transitional justice. They believe that the economic compensation must have a wide scope and include addressing the impact of the violation of civil and political rights as well as economic, social and cultural rights. Compensation must recognise the loss of family members, time and work in prison, the denial of the right to education, pension, contributions at work, housing, healthcare, loss of property, and denial of right to family, political, social and cultural life.

Keywords: Transitional justice, economic reform, reparation, survivors perspectives.

Shkelja e të drejtave të njeriut dhe pasojat

Shkeljet e të drejtave të njeriut në mënyre masive janë shumë të përhapura dhe kanë prekur mbi gjysmën e vendeve anembanë globit që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore¹. Këto shkelje përfshijnë përjetime të skajshme si për shembull vrasje apo tortura, por edhe dhunim sistematik të të drejtave civile, politike, shoqerore, ekonomike dhe kulturore. Shkeljet e të drejtave të njeriut ndikojnë jo vetëm tek viktimat e drejtpërdrejta por dhe brezat pasardhës^{2 3}. Te mbijetuarit perballen me pasojat e dhunimit për dekada me radhë. Gjithashtu, ata mbartin shqetësimin sesi pasojat e shkeljeve të të drejtave të tyre mund të ndikojnë në komunitetet ku ata jetojnë, mbarë shoqërinë, deri dhe brezat e ardhshëm. Aftesia dhe mundësia për të perballuar te shkuaren ndikohet drejtpërdrejt nga reformat e drejtësisë në vijimësi⁴ të cilat njihen si Reforma te Drejtësisë Tranzitore.

Reformat e Drejtësisë Tranzitore

Terminologjia e ‘Drejtësisë Tranzitore’ u formulua në pjesën e dytë të shekullit të 20-të, ku shume vende si ato te Europes Lindore dhe Qendrore, Amerikës se Jugut dhe Afrikës se Jugut, perjetuan transformime shoqerore dhe politike qe kishin si qëllim përmbysjen e regjimeve jo demoratike dhe jo pluraliste. Pyetje të rëndesishme u shtruan në lidhje me mënyrat se si shoqëritë duhet të përballen me krimet dhe se kush duhet të jetë përgjegjës për

¹ Marshall, Monty G., and Benjamin R. Cole. "Global report on conflict, governance and state fragility 2008." *Foreign Policy Bulletin* 18, no. 1 (2008): 3-21.

²Këllezi, Blerina, Aurora Guxholli, Clifford Stevenson, Juliet Ruth Helen Wakefield, Mhairi Bowe, and Kay Bridger. "'Enemy of the people': Family identity as social cure and curse dynamics in contexts of human rights violations." *European Journal of Social Psychology* 51, no. 3 (2021): 450-466.

³ Bombay, Amy, Kimberly Matheson, and Hymie Anisman. "Perspectives on intergenerational transmission of trauma: The case of Aboriginal peoples in Canada." *Social issues in living color: Challenges and solutions from the perspective of ethnic minority psychology: Promoting health and well-being* In T. V. Cooper, M. C. Skewes, K. B. Schmalig, & A. W. Blume (Eds.), Praeger/ABC-CLIO. (2017): 171–196.

⁴ Ibid 2.

të marrë këto vendime^{5 6}. Që në fillim, ishte e qarte se drejtësia penale duhet të jetë e pandarë nga reforma që kanë si qëllim paqen, stabilitetin dhe demokracinë^{7 8}. Ky konkluzion çoi drejt zhvillimit të Reformave të Drejtësisë Tranzitore (RDT). RDT-të janë mekanizma ligjorë apo jo-ligjorë (p.sh., moral ose politik) që veprojnë në nivel shtetëror dhe shoqëror për të vënë në vend drejtësinë dhe për të lehtësuar arritjen e paqes dhe bashkimit të shoqërisë pas luftërave, konflikteve, apartaideve dhe regjimeve diktatoriale⁹. RDT-të mund të kenë qëllime të ndryshme, (p.sh. dënimin e fajtorëve) por në realitet, pasojat mund të shtrihen më gjerë dhe të ndikojnë në promovimin e pajtimit dhe të rindërtimit shoqëror^{10 11}, në rehabilitimin e viktimave¹² dhe deri në çrrënjosjen e pabarazisë shoqërore¹³.

Reformat e Drejtësisë Tranzitore të ndërmarra deri më tani në mbarë globin përfshijnë ndjekjen penale të plotë ose të pjesshme (p.sh. në rast amnestie të grupeve të caktuara) në Gjykatat Penale Kombëtare ose Ndërkombëtare¹⁴. Ashtu si mekanizmat e tjerë, drejtësia penale mund të ketë një ndikim shumë më të gjerë sesa objektivi i drejtpërdrejtë. Për shembull, Gjykatat Ushtarake ose Gjykata Penale Ndërkombëtare (Nuremberg dhe Tokyo)¹⁵, kanë ndikuar pozitivisht si mjete parandaluese, por dhe kanë rritur përgjegjshmërinë, kanë shërbyer për dokumentimin historik të krimeve, kanë ndikuar në zhvillimin e mëtejshëm të institucioneve ndërkombëtare të drejtësisë penale dhe jurisprudencës, si dhe kanë shpërndarë në

⁵ Schabas, William A. "Genocide trials and gacaca courts." *Journal of International Criminal Justice* 3, no. 4 (2005): 879-895.

⁶ Teitel, Ruti G. *Transitional justice*. Oxford University Press on Demand, 2000

⁷ Ibid

⁸ Shaw, Rosalind, Lars Waldorf, and Pierre Hazan, eds. *Localizing transitional justice: Interventions and priorities after mass violence*. Stanford University Press, 2010.

⁹ Ibid 6

¹⁰ Mani, Rama. *Beyond retribution: Seeking justice in the shadows of war*. Polity, 2002.

¹¹ Sideris, Tina. "War, gender and culture: Mozambican women refugees." *Social science & medicine* 56, no. 4 (2003): 713-724.

¹² Patel, Nimisha. "Human rights-based approach to applied psychology." *European Psychologist* 24:2, (2019). 113-124

¹³ Nagy, Rosemary. "Transitional justice as global project: Critical reflections." *Third World Quarterly* 29, no. 2 (2008): 275-289.

¹⁴ Pensky, Max. "Amnesty on trial: impunity, accountability, and the norms of international law." *Ethics & Global Politics* 1, no. 1-2 (2008): 1-40.

¹⁵ Futamura, Madoka. *War crimes tribunals and transitional justice: The Tokyo trial and the Nuremberg legacy*. Routledge, 2007.

mënyrë të drejtpërdrejtë dëmet individuale të viktimave¹⁶. Edhe pse mekanizmat tranzitorë të drejtësisë penale mund të luajnë një rol qendror në transformimin e rendit politik¹⁷, zbatimi i tyre ka qenë i kufizuar dhe madje i kritikuar në rastet kur ushtrohet nga shteti. Kjo formë e drejtësisë, ashtu si çdo mekanizëm i zbatuar pa reforma shoqëruese, është e kufizuar si në zbatim, ashtu dhe në përfitimet që mund të arrijë në aspektin funksional dhe atë simbolik.

Mekanizmat që shkojnë përtej ndjekjes penale janë ato që synojnë dëmshpërblimin e viktimave dhe pajtimin mes palëve. Këto mekanizma sollen një ndryshim pozitiv për mbrojtjen e të drejtave të njeriut për viktimat dhe për trajtimin e tyre me respekt në procesin e vendosjes së drejtësisë¹⁸. Për shembull, drejtësia historike (ku përfshihen komisionet e së vërtetës, tregimi i së vërtetës dhe ceremonitë përkujtimore) mund të trajtojë disa nga kufizimet e drejtësisë penale duke krijuar lidhjen midis së vërtetës dhe pushtetit politik¹⁹, por gjithashtu duke ofruar një formë më kolektive të drejtësisë^{20 21}. Drejtësia administrative ose reformat administrative (p.sh. vetingu, lustracioni, kufizimi i pjesëmarrjes politike, civile dhe drejtuese i autorëve të shkeljeve të të drejtave të njeriut) mund të përdoren gjithashtu me sukses dhe të ndikojnë në rendin politik në tranzicion dhe më gjerë²². Po ashtu, jurisprudenca tranzitore luan një rol te veçantë gjatë periudhave të ndryshimeve politike dhe regjimeve në tranzicion. Ajo mund të ketë ndikim afatgjatë në transformimin e regjimeve ligjore, por edhe të normave shoqërore²³. Së fundi, dëmshpërblimet mund të ofrojnë përfitime funksionale dhe simbolike dhe të përmbushin disa nga nevojat individuale dhe kolektive pas dëmit²⁴.

Pavarësisht vlerës që mbart secila nga këto reforma, disa prej tyre janë studiuar dhe analizuar

¹⁶ Ibid 15.

¹⁷ Ibid 6.

¹⁸ Doak, Jonathan. "Victims' rights in criminal trials: Prospects for participation." *Journal of Law and Society* 32, no. 2 (2005): 294-316.

¹⁹ Ibid 6.

²⁰ Brants, Chrisje, and Katrien Klep. "Transitional justice: history-telling, collective memory and the victim-witness." *International Journal of Conflict and Violence (IJCIV)* 7, no. 1 (2013): 36-49.

²¹ Ibid 13.

²² Ibid 6.

²³ Posner, Eric A., and Adrian Vermeule. "Transitional justice as ordinary justice." *Harvard Law Review* 117, no. 3 (2004): 761-825.

²⁴ Walker, Margaret Urban. "Restorative justice and reparations." *Journal of social philosophy* (2006): 377-395

më shume se të tjerat²⁵. Reforma ekonomike është një nga ato më pak të studiuarat deri më tani²⁶.

Rëndësia e qasjes së studimit

Qasja e përdorur për të analizuar përvojat e të mbijetuarve është e rëndësishme. Ajo duhet të përfshijë vetë këndvështrimet e të mbijetuarve dhe të familjareve të tyre në studimin, si dhe në hartimin dhe zbatimin e RDT-ve. Me përjashtim të kriminologjisë viktimologjike që bazohet tek krimet individuale dhe ato të kryera në kohe paqeje²⁷, tradicionalisht, zërat e të mbijetuarve mungojnë në sistemin e drejtësisë. Në masë dërrmuese, të mbijetuarit kanë pasur rol të kufizuar (ligjërishit dhe/ose në praktikë) në procese që kanë të bëjnë me ndjekjet penale, dënimet dhe dëmshpërblimet, përfshi dhe ato vendimmarrëse. Ky rol i kufizuar ka pasoja serioze për mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të të mbijetuarve, si dhe për përfshirjen e versionit të vërtetës së tyre brenda sistemeve të drejtësisë²⁸. Ndjenja e pafuqisë që përjetojnë të mbijetuarit për shkak të përjashtimit nga procesi i drejtësisë²⁹ jo vetëm që redukton aftësinë e tyre për të kërkuar drejtësi, por ndikon deri në zhgënjimin dhe largimin nga sistemi i drejtësisë^{30 31}. Hulumtime mbi drejtësinë procedurale³² mbështesin rëndësinë që ka pjesëmarrja dhe kontributi i të mbijetuarve në procesin e drejtësisë. Të mbijetuarit mund të identifikojnë reforma më të qëndrueshme, të përshtatshme dhe më të pranueshme në nivel

²⁵ McEvoy, Kieran, and Kirsten McConnachie. "Victimology in transitional justice: Victimhood, innocence and hierarchy." *European Journal of Criminology* 9, no. 5 (2012): 527-538.

²⁶ Urueña, René, and María Angélica Prada-Urbe. "Transitional justice and economic policy." *Annual Review of Law and Social Science* 14 (2018): 397-410.

²⁷ McEvoy, Kieran, and Lorna McGregor, eds. *Transitional justice from below: Grassroots activism and the struggle for change*. Bloomsbury Publishing, 2008.

²⁸ Ibid 18.

²⁹ Ibid 18.

³⁰ Këllezi, Blerina, Juliet RH Wakefield, Mhairi Bowe, Andrew Livingstone, and Aurora Guxholli. "Communities as conduits of harm: A social identity analysis of appraisal, coping and justice-seeking in response to historic collective victimization." *Journal of Community & Applied Social Psychology* (2022): 1-17

³¹ Ibid 2.

³² Van Camp, Tinneke, and Jo-Anne Wemmers. "Victim satisfaction with restorative justice: More than simply procedural justice." *International Review of Victimology* 19, no. 2 (2013): 117-143.

vendor, veçanërisht kur mekanizmat ndërkombëtarë ose kombëtarë kanë dështuar ose nuk mund të zbatohen^{33 34}. Këndvështrimet e vetë të mbijetuarve mund të ndihmojnë gjithashtu në identifikimin se kur dhe ku qasjet vendore mund të jenë problematike apo të dëmshme^{35 36}. Për këto arsye, ky studim shqyrton pikëpamjet e vetë të mbijetuarve dhe të familjarëve të tyre mbi proceset e ndryshme të drejtësisë tranzitore, përfshirë dhe pasojat dhe reformat ekonomike dhe dëmshpërblimet.

Qëllimi i studimit

Ky studim synon të vendosë pikëpamjet e ish të përndjekurve politik si të mbijetuar të krimeve komuniste në qendër të të kuptuarit të drejtësisë tranzitore, duke marrë parasysh kontekstin socio-politik ku ndodhën shkeljet. Studimi i parë analizon këndvështrimin e tyre mbi drejtësinë tranzitore. Këndvështrimet në fjalë u mblodhën nëpërmjet intervistave të thelluara me ish të përndjekur politik që jetojnë në Shqipërinë e pas diktaturës. Studimi i dytë hulumton përparësinë që ish të përndjekurit politik i japin proceseve të ndryshme të drejtësisë duke përdorur si metodologji anketimin. Së bashku, këto dy studime kanë për qëllim t'u përgjigjen katër pyetjeve në lidhje me pasojat e krimeve të komunizmit si dhe reformave tranzitore, në vecanti ato ekonomike:

- Cilat dëme/krime duhet të dëmshpërblejë drejtësia tranzitore?
- Si lidhet dëmshpërblimi ekonomik me format e tjera të drejtësisë tranzitore?
- Kush duhet të dëmshpërblehet?
- Kush duhet të kerkojë dëmshpërblim?

³³ Lundy, Patricia, and Mark McGovern. "Whose justice? Rethinking transitional justice from the bottom up." *Journal of law and society* 35, no. 2 (2008): 265-292.

³⁴ McEvoy, Kieran. "Travel, dilemmas and nonrecurrence: Observations on the 'respectabilisation' of transitional justice." *International Journal of Transitional Justice* 12, no. 2 (2018): 185-193.

³⁵ Kellezi, Blerina, and Stephen Reicher. "The double insult: Explaining gender differences in the psychological consequences of war." *Peace and Conflict: Journal of Peace Psychology* 20, no. 4 (2014): 491-504.

³⁶ Ibid 30.

Konteksti i studimit

Diktatura komuniste në Shqipëri u vendos në fund të Luftës së Dytë Botërore dhe zgjati deri në fillim të viteve 1990³⁷. Rreth 6,027 njerëz u vranë, 34,135 u burgosën dhe 59,009 (rreth 3% e popullsisë) u internuan, ndërsa shumë të tjerëve iu mohuan të drejtat politike, civile, ekonomike, sociale dhe kulturore, veçanërisht nëse shiheshin si kërcënim për diktaturën³⁸. Diktatura në Shqipëri ndikoi në shumë aspekte të jetes së personave të përndjekur. Atyre iu mohuan të drejtat për pjesëmarrje në jetën civile dhe politike. Këtu përfshihen e drejta e jetes, e integritetit fizik dhe mendor dhe e drejta e sigurisë, liria nga torturat dhe denimet e pameshirshme dhe çnjerëzore, pjesëmarrja në proces të drejte gjyqimi, liria e fjalës, e mendimit dhe e fesë, privatesia, jeta familjare, si dhe e drejta për barazi dhe mos diskriminim. Atyre iu mohuan dhe të drejtat për pjesëmarrje në jetën ekonomike, shoqërore dhe kulturore³⁹ si e drejta e punës, e standartit të jetesës (ushqim, veshje, banesë), shërbimet e shëndetit mendor dhe fizik, e drejta e arsimit dhe shumë të tjera⁴⁰. Këto të drejta nderlidhen me njëra-tjetrën dhe shpesh realizohen kur mbivendosen (p.sh. e drejta e punës me të drejtën e fjalës së lire dhe kërkesës për kushte me të mira pune).

Në tridhjetë vitet që pas rënies së diktaturës, kanë ndodhur vetëm pak reforma të drejtësisë tranzitore dhe viktimat ndihen të injoruar, të keqkuptuar dhe të paafte për të zgjidhur padrejtësitë e përjetuara gjatë diktaturës⁴¹. Austin dhe Ellison⁴², përmbledhin proceset kryesore të drejtësisë që kanë ndodhur pas rënies së diktaturës në Shqipëri. Ato përfshijnë një hetim në shkallë të vogël të krimeve ekonomike të disa prej udhëheqësve të diktaturës si dhe dënime për abuzime financiare (në 1993-1994). Proceset e lustracionit u zhvilluan gjithashtu gjatë viteve '90, por këto u kritikuan se ishin të pasakta, të kufizuara si

³⁷ Fevziu, Blendi. *Enver Hoxha: The Iron Fist of Albania*. Bloomsbury Publishing, 2016.

³⁸ Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri. Tërhequr më 9 Shtator 2021. <http://www.iskk.gov.al/en/activities/>.

³⁹ Deklarata e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut, 1948

⁴⁰ Këllezi, Blerina, Aurora Guxholli, and C. Stevenson. "The dictatorship from the victims' perspective. the role of the families." In *The outcast from the power: Prisons, internment and forced labour in Albania 1945–1990*. Tirana: Konrad Adenauer Foundation, Albania. (2019); 406–418.

⁴¹ Ibid 2.

⁴² Austin, Robert C., and Jonathan Ellison. "Post-communist transitional justice in Albania." *East European Politics and Societies* 22, no. 2 (2008): 373-401

dhe të shfrytëzuara si një mjet politik^{43 44}. Gjatë viteve '90 pati edhe disa raste të ndjekjes penale për krime kundër njerëzimit. Në vitin 1994, njëzet e katër zyrtarë të lartë komunistë u akuzuan sipas ligjit të gjenocidit. Kompensimi ekonomik i ish te burgosurve politik po ashtu filloi në vitet '90⁴⁵, por ky mbetet i paplotesuar. Që atëherë, disa ndryshime të rëndësishme kanë ndodhur. Në vitin 2010, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Institutin e Studimeve të Krimeve dhe të Pasojave të Komunizmit, i cili synon të vlerësojë dhe dokumentojë këto krime. Vitet e fundit është krijuar edhe Autoriteti për Informimin e Dokumenteve të Ish-Sigurimit të Shtetit.

Studimi I. Methodologjia

Intervista gjysmë të strukturuar u realizuan me 27 ish të përndjekur politik dhe pasardhes të tyre. Intervistat u analizuan me synim zbulimin e kuptimit dhe të përkufizimit të drejtësisë nga të intervistuarit. Pjesëmarrësit u zgjedhën me ndihmën e organizatave vendore që mbështesin ish të përndjekurit politik dhe persona të njohur nga studiuesit. Intervistat u zhvilluan në gjuhën shqipe nga 3 studiues dhe studimi u miratua nga Komisioni Etik i Universitetit Nottingham Trent në Britaninë e Madhe. Intervistat filluan me pyetje të përgjithshme, si 'Më tregoni diçka për familjen tuaj' dhe u pasuan nga pyetje më të detajuara rreth drejtësisë, si 'Çfarë duhet të ndodhë për të shpërguar vuajtjen tuaj?'. Intervistat u regjistruan në format *audio* dhe u zbardhën *verbatim*. Idete e perbashketa në intervistat e ndryshme u analizuan me anë të gjashtë hapave të analizës tematike⁴⁶.

Studimi II. Metodologjia

⁴³ Ibid 42.

⁴⁴ Elbasani, Arolda, and Artur Lipinski. "Transitional justice in Albania: historical burden, weak civil society, and conflicting interests." In *Transitional Justice and Civil Society in the Balkans*, pp. 105-121. Springer, New York, NY, 2013.

⁴⁵ Kalemaj, Ilir. "Transitional justice and democratic consolidation in post-communist Eastern Europe: Romania and Albania." *Eastern Journal of European Studies* 12, no. 1 (2021): 81-103.

⁴⁶ Braun, Virginia, and Victoria Clarke. "Thematic analysis." *Analysing qualitative data in psychology*. London: Sage Publications Ltd (2021): 128-47.

Pjesëmarrësve iu kërkua të identifikonin 5 proceset më të rëndësishme të drejtësisë tranzitore sipas tyre. Ata mund të zgjidhnin nga një listë e parapergatitur e RDT-ve ose mund të paraqesnin RDT-të e tyre. Listat e parapergatitura u hartuan bazuar në rezultatet e analizës së studimit të parë dhe të literaturës. Pjesëmarrësit u ftuan t'i shkruanin përgjigjet në një anketë me tekst të hapur. Anketimi u krye ballë për ballë ose online me gjithsej 130 ish të përndjekur ose pasardhës të tyre. Përgjigjet u analizuan me anë të analizës së përmbajtjes, e cila numëron se sa shpesh ka ndodhur një "shembull" (në këtë rast, mekanizmi i drejtësisë) në të dhëna⁴⁷. Mekanizma të ngjashëm drejtësie u grupuan nën të njëjtin titull, megjithëse përshkrimi origjinal i dhënë nga pjesëmarrësit ruhet në kllapa. Përmendja e secilit mekanizëm është numëruar sistematikisht në çdo anketë.

Rezultatet

Pjesëmarrësit dëshmuuan përvoja të shumta të shkeljeve të të drejtave gjatë diktaturës, të cilat përfshijnë të drejtat civile dhe politike, si dhe të drejtat sociale, ekonomike dhe kulturore. Disa prej këtyre shkeljeve përfshinin burgim, punë të detyruar dhe internim, humbje të shtëpisë, të pronës dhe vendit të punës, ndarje të detyruar nga anëtarët e familjes, humbje të së drejtës për strehim, punë dhe arsimim, mosnjohje e kontributeve ekonomike, e arritjeve të ndryshme si p.sh. ato arsimore, humbje të së drejtës për kujdes shëndetësor, tortura fizike dhe psikologjike, përjashtim nga jeta sociale, kulturore, familjare dhe komunitare, poshtërim dhe sprovat publike, si dhe varfëri dhe izolim i skajshëm. Për pasojë, edhe nevojat e tyre në lidhje shpëtimin e shkeljeve të të drejtave dhe lirive dhe lehtësimin e pasojave të vuajtjeve të së kaluarës ishin të shumëanshme. Në analizën e paraqitur në këtë studim, vëmendje e veçantë i kushtohet dëmshpërblimit ekonomik dhe elementeve perberes të tij. Çështjet kryesore që trajtohen në këtë studim përfshijnë a) dëme/kryeve kriminale që duhet të dëmshpërblehen nga drejtësia tranzitore, b) lidhjet e dëmshpërblimit ekonomik me forma të tjera të drejtësisë tranzitore, c) kush duhet kompensuar dhe d) kush duhet ta kerkoje kompensimin.

Tema I: Cilat dhunime të të drejtave e lirive që ndikuan në aspektin ekonomik duhet të adresohen nga drejtësia tranzitore?

⁴⁷ Ryan, Gery W., and H. Russell Bernard. "Data management and analysis methods." *Handbook of qualitative research 2* (2000): 769-802.

Per pjesëmarresit, shumë nga shkeljet e te drejtave gjatë diktaturës lidhen në mënyrë te drejtëpërdrejtë ose të tërthortë me aspektin ekonomik. Përveç tragjedisë/dhimbjes njerezore si pasojë e vrasjes së një familjari, shpesh humbja e jetes apo burgimi çonte dhe në humbje të burimit të të ardhurave familjare (Citim 1).

Citim 1: Gjatë kohës që ai ka qenë në burg ne kemi vuajtur shumë, sepse mamasë sime në (emer qyteti) nuk i jepnin punë, as punë krahu. Kur paraqitej në zyrën e punës i thoshin shko ha ato që të ka lënë yt'shoq⁴⁸.

Burgimi shpesh perfshinte dhe punë të papaguar, qe ende mbetet e pashlyer per shume nga te mbijetuarit (Citim 2):

Citim 2: Unë kam punuar dhe ti s'më ke paguar. Më jep punën e papaguar. Dhe çfarë bëri qeveria? Dha 'letra me vlerë' u quajtën në atë kohë. Dhe këto letra i grumbulluan nëpër banka ato, s'morën asnjë gjë edhe humbën se nuk i vuri shteti në funksionim. Mbetën letra bakalli. Mbas 6 vjetësh protesta më në fund e aprovuan⁴⁹.

Përndjekja sillte shpesh dhe sekuestrimin e pronës dhe të pasurisë, një çështje që ende sot mbetet kryesisht e pazgjidhur në Shqipëri. Pasojat e varferisë së skajshme gjatë diktaturës prekin ende një pjesë të shtresës së të ish të përndjekurve, të cilëve jo vetëm iu morën pronat, por dhe nuk i reflektohet munda i punës në pensione apo reformat ekonomike që janë zbatuar deri tani (Citim 3 dhe 4):

Citim 3: Mirëpo si u thashë që u arrestua, të gjitha pronat u sekuestruan, i mori shteti i atëherëshëm dhe sot luftojmë për të marrë dhe pronat tona, ç'është e drejta. Akoma nuk i kemi marrë.... Se unë jetoj me dy pensione minimale⁵⁰.

Citim 4: Kisha ruajtur leke për të blerë një lavatriçe për nënen dhe një frigorifer edhe prisnim nga dita në ditë të vinin. Edhe këto shiteshin dhe me autorizim. Kur më

⁴⁸ Intervista gojore 5.

⁴⁹ Intervista gojore 7.

⁵⁰ Intervista gojore 20.

arrestuan mua, vajtën kontroll në shtëpi. S'panë gjë, morën ato që të thashë, enciklopedinë, atë fjalorin, edhe morën paratë. Kur u lirova nga burgu vajta në këtë, në Degën e Brendshme në (emer qyteti). I thashë unë nuk gjeta paratë. Ik shlyeja partisë, s'ke punë me paratë! T'i kanë vjedhur të tjerë⁵¹.

Gjatë diktaturës, vuajtjet që pasonin humbjen e njerezve dhe mohimin e shumë të drejtave si e drejta për arsimim, për pune, për shpërblim financiar të punës së kryer etj., u shoqeruan shpesh dhe me varferi të skajshme (Citim 5, 6, 14):

Citim 5: Neve na hiqnin të drejtën e triskave. Po, mujore. 400 gr bukë ishte triska ordinere që e merrte gjyshja ime, dhe ne të mos ngopim barkun me bukë⁵².

Citim 6: Nuk kishin të drejtë të kishin triska për të marrë ushqime për shumë vite me radhë. Kështu që as të drejtën e punës sime mëje nuk ia jepnin dhe, shumë, shumë vonë, rreth viteve '70, kur ekonomia na kishte rënë shumë në familje, mezi mundi të hynte punëtore në një fabrikë duhani⁵³.

Siç permendet me lart, disa prej shkeljeve më të rënda ishin mohimi i te drejtes për punë, i punësimit në profesionin e duhur apo i arsimimit (Citim 7).

Citim 7: Kam bërë shkollën natën, ekonomikun, por që nuk e gëzova asnjëherë, nuk punova asnjëherë, sepse kudo që shkonja ishte vula në kurriz. Mbarova ekonomikun natën me nota shumë të mira dhe nuk guxoja të kërkonja shkollë të lartë se e dinja që nuk më jepej. U detyrova të punoj një zanat të thjeshtë sepse punë s'na jepnin⁵⁴.

Pjese e vuatjes ishte dhe pasiguria e punës. Shpesh të përndjekurit politik detyroheshin te nderronin pune dhe te udhëtonin me ore te tera kur emëroheshin në qendra pune shumë larg vendit të banimit (Citim 8)

⁵¹ Intervista gojore 17.

⁵² Intervista gojore 1.

⁵³ Intervista gojore 22.

⁵⁴ Intervista gojore 11

Citim 8: U arrestu baba edhe më hoqën nga puna edhe s'kishte... Unë njëherë kujtova se ra qiella, si kom me ia ba? Në fermë më çune. Edhe aty nuk më lejshin rehat se ferma ishte e hapun shum, unë isha në një katun 4 km larg (emer qyteti). Prej aty na çojshin sa her një grup si puna jeme, na çojshin një her në (emer fshati), është një fshat një 11 km jash (emer qyteti), gjithanejna⁵⁵.

Shpesh të përndjekurve politik nuk u njihej merita e punës apo të tjera kontribute shoqërore dhe iu mohoheshin arritje të ndryshme (Citim 9):

Citim 9: Në tabelë. Nuk lejohesh. Ose një mësues ta thoshte troç që nuk të ve 10 se ti je djalë armiku. Ti e ke mësu për 10 po unë s'të ve 10. Ti je djalë armiku dhe unë nuk do ta përdor 10-tën për ty pavarësisht se ti e meriton. Pra këto ishin disa mënyra⁵⁶.

Mohimi i të drejtave dhe lirive të njeriut paten pasoja gjate por dhe pas diktatures kur te përndjekurit nuk mund te arsimoheshin apo te punësoheshin në pozicione pune të mirëpaguara, ose kur pensionet e tyre ishin dhe mbeten shume te vogla si pasoje e punes se detyruar. Nje forme tjetere e mohimit ishte dhe jetesa ne kushte shume te veshtira e cila ndikonte ne menyre te drejteperdrejte dhe afatgjate ne shendetin fizik dhe mendor (Citim 10):

Citim 10: Kemi jetu në bodrumet e pallateve (emri pallatit), na hynte uji 80 cm. Dhe nuk çante kokë njeri, dhe kur shkonim në Komitet, nje vinte nga mbrapa që të mos ta takonim ne se do ankoheshim se s'kemi shtëpi dhe jemi në ujë. Prapë vula ishte gjithmonë prapa kurrizit⁵⁷.

Një shembull i mohimit të të drejtës për perkujdesje shendetesore deri në vrasje ilustruhet në citimin në vijim (Citim 11):

Citim 11: Edhe e shtrojmë me urgjencë në spital nenen. Aty një doktor që më njihte mu thotë, me dhimbje të madhe po të them, merre nanën edhe çoje në shpi se s'po dojn me i dhan gjak. A kupton tani ku arrin kulmi? Edhe ajo ma von vdiq⁵⁸.

⁵⁵ Intervista gojore 27

⁵⁶ Intervista gojore 14

⁵⁷ Intervista gojore 13

⁵⁸ Intervista gojore 18

Nje pjese e vuajtjes u shkaktua prej lidhjes së ngushtë që ekziston mes demeve apo veshtiresive fizike me ato mendore. Keto deme jane afatgjata dhe ndihen ende ne ditët e sotme (Citim 12).

Citim 12: I kam me protezë të dy gjunjët. I kam operuar. Nga të ngriturat e vagonëve. Një vagon peshonte 2 tonë. Në një galeri ku s'kish asnjëri, ku ti vetëm me një dritë kështu, me pirit. Kush do ta ngrinte vagonin nga shinat? I vinje kurrizin këtu edhe bënje luftë me vetveten... isha i ri unë, isha 30 vjeç. Nuk ta jepte, e dha më vonë. Të dy gjunjët, këtë gjurin s'ka gjashtë muaj që e kam operuar, këtë këtu⁵⁹.

Mohimi i te drejtave dhe lirive behej dhe me i veshtire per t'u perballuar kur format e denimit ishin të skajshme si burgim apo internim. Kjo shkaktonte ndarje nga njerezit e dashur dhe te besuar qe mund te ofronin ndihme ne kohe te veshtira (Citim 13):

Citim 13: U internuan në (emer qyteti) edhe aty qëndruan 47 vjet.... Nëna ime ishte shtatzënë me mua dhe kur shkoi në (emer qyteti) pas dy muajsh kam lindur, d.m.th. unë linda në (emer qyteti)⁶⁰.

Kufizimi i lirisë me anë të burgimit apo internimit kishte pasoja të rënda jo vetëm tek vetë individët e dënuar por gjithë familjarët, përfshi fëmijët e të moshuarit, që vareshin ekonomikisht prej tyre (Citim 14).

Citim 14: Dhe u ndje edhe ajo vuajtja një çikë më e madhe, një çikë më tepër, sepse kur vinte triskat e racionit, sado që mbanin radhën, kur i dinin që ishin me njollë në biografi, gjithmonë i çonin në fund, tim atë e çonin. P.sh. i vinte radha dhe i thoshte ti shko në fund, i thoshte, do vijë ky tjetri. Pra, ndodhte gjithmonë kjo gjë. Te qumështi, për shembull gjyshen time, e çonin në fund përherë. Prisje ti në radhë, thoshte s'ka për ty. S'ka për ty. Dhe kjo vinte për shkak të persekutimit, kuptohet. Sepse mbrapa

⁵⁹ Intervista gojore 21

⁶⁰ Intervista gojore 2

ishte dikush tjetër që ishte... Dhe gjithmonë me të persekutuariat kjo ndodhte. Kjo është pak-a-shumë historia e familjes sime⁶¹.

Perveç ndarjes fizike prej familjarëve që vinte si pasoje e internimit, në realitet kishte dhe ndarje të detyruara brenda familjes apo komuniteteve ekzistuese. Diktatura kontrollonte dhe të drejtën e jetes familjare ku të përndjekurit politik i kishin mundësitë e zgjedhjes të kufizuara (Citim 15). Kjo detyronte të vetmen mënyrë të krijimit të familjes në rrethana kur të dy bashkeshortet jetonin në kushte dhe varferi të skajshme.

Citim 15: Ishin të ndalume në nuk kishim të drejtë d.m.th. si armiq që quheshim në atë kohë, nuk kishim të drejtë edhe martesën për t'i bërë mes pjesës tjetër që ndoshta s'ishte dhe komuniste po ishte një pjesë qytetare, në punë të vet, dhe ato nuk lejoheshin të martoheshin me ne po dhe ne nuk lejoheshin⁶².

Vuajtja njerëzore në gjithë larminë e formave të përshkruara më sipër (Citim 1-15) nuk është reflektuar ende në reformat që kanë për synim rehabilitim shoqëror, politik, ekonomik dhe profesional të ish të përndjekurve politik. Këto forma të shumefishta vuajtjeje dëshmojnë nevojën e dokumentimit të detajuar e gjithëpërfshirës të krimeve të komunizmit si dhe reflektimin e tyre në reformat e dëmshpërblimit.

Tema II: Pasojat e krimeve janë afatgjata dhe ndikojnë dhe pas diktatures

Ndonese në parim krimet u ndalën me rënien e diktatures, pasojat e tyre vazhdojnë dhe në ditët e sotme. Një formë shumë e rëndësishme e padrejtesisë është edhe vonesa në njohjen dhe zbatimin e reformave të dëmshpërblimit. Padrejtësia për pjesëmarrësit merr dy forma. Forma e parë i referohet mungesës së reformave që vëne në vend drejtësinë (Citim 16):

Citim 16: Për arsye se demokracia në Shqipëri nuk erdhi ashtu siç e pritshim dhe e dëshironim në të përndjekurit politik, në kuptimin global, një demokraci që të kishit të drejtat dhe liritë tuaja, një demokraci që të kishe... të kishte konkurrencë si në

⁶¹ Intervista gojore 19

⁶² Intervista gojore 20

politikë, si në punësim, si në të tjera. Një demokraci që prona t'i njifej pronarit; një demokraci që kriminelët që kishin kryer krime ndaj familjeve tona të dënoheshin, por jo të nderohen. Pra, e gjithë kjo malgamë e kësaj demokracie ndodhi se demokracia në Shqipëri u frenua nga pushteti i fundit diktatorial që po lironte karriget e pushtetit por nuk po lironte veprimet ideologjike që t'i shërbenin shoqërisë shqiptare. Pra, ne ndodhemi, ndodhemi përballë një sitaute kaotike 26 vjeçare. Në Shqipëri mbrohet diktatori, një ndër diktatorët më të egër botërorë, deformohet historia, nuk pranohet e vërteta, luhet me ndjenjat e qytetarëve që u persekutuan. Persekutimi i tyre përdoret politikisht dhe aspak ligjërisht. Nuk asht ba asgja nga shteti i ashtuqujtun demokratik në kuptimin psiko-analizë të vujtjeve të këtyre familjeve duke trajtuar si të burgosurit politik, si familjen që ishte pushkatuar një pjesëtar i tyre dhe që nga pushkatimi i pjesëtarit të familjes dhe deri në vitet '90 atij i mohoheshin të gjithë të drejtat e liritë e njeriut, i mohoheshin prona, i konfiskohej prona... Për shembull, unë jam djali i një të burgosuri politik,.. Më është mohuar arsimi, jam lejuar që të vazhdoj shkollën e mesme mbas 17 vjetësh që kam mbaruar 8-vjeçaren dhe kur ka ardhur i ashtuquajtur i sistem demokratik kam mbaruar dhe arsimin e lartë. Du të trajtoj problem këtu të... çfarë ndodhte me të burgosurit është më mirë që të intervistosh të burgosurit që kanë qenë në burg. Po çfarë ndodhte me ne jashtë burgut? Jashtë burgut, me familjet e të burgosurve⁶³.

Forma e dyte lidhet me vështirësinë për të shfrytëzuar mundësitë e krijuara nga sistemi i ri. Kështu, dhe kur ndryshimet janë miratuar, disa mbeten të vështira për t'u zbatuar pasi nuk mund të çbëjnë demot që janë të shumta dhe të akumuluar në kohë (Citim 17 dhe 18):

Citim 17: E vetmja gjë që ka fituar pjesa më e madhe e të burgosurve, që kishin nga një të arratisur atëherë, morën udhën e ikën në Amerikë, ikën andej, ku kishin njerëzit e tyre. Po, fituan lirinë. Fituan lirinë. Asgjë tjetër. Këta aty i kanë shpresat që të marrin ato lekët. Aty e kanë shpresën. Ku ta gjejnë shpresën tjetër? Ata të zinjve nuk u jepej shkollë, ku të bëjnë shkollë, janë nga 70 vjeç, nga 80 vjeç, nga 60 vjeç. Ata që janë të rinj janë të sëmurë, janë... S'kanë zanat e s'kanë... Është një tragjedi kombëtare⁶⁴.

⁶³ Intervista gojore 26.

⁶⁴ Intervista gojore 12

Citim 18: Në '90-ën, kuptohet, kur me teori të gjithë ishim të barabartë sepse u nisëm të barabartë, nuk ishim në fakt të barabartë sepse babi im nuk kishte shkollë të lartë, ime më nuk... pra, të përndjekurit politik nuk kishin shkollë të lartë. Dhe, duke qenë se nuk kishin mundësi për të bërë shkollën e lartë atëherë, ishte shumë e vështirë që... Ti duhet të punoje, apo duhet të rrije që të bëje shkollën e lartë?! Ndërkohë kishe fëmijë, kishe të gjitha. Prandaj shanset nuk ishin dhe aq të mëdha. Paçka se, me thënë të drejtën... Iu dha mundësia edhe tim eti dhe time mëje po nuk mund ta bënin dot se o duhet të linin punën, ose duhet të bënin shkollën⁶⁵.

Keto veshtiresi ne zbatimin e reformave pasqyrojnë mungesën e mundësive në periudhën e pas diktaturës me të cilat u përball shtresa e ish të përndjekurve politik (Citim 19 dhe 20).

Citim 19: Atëherë, kur ne na hoqën internimin ne kishim të drejtë qarkullimi që të iknim, po ku do iknim? S'kishim as shtëpi, as katandi, asgjë prej gjëje. ...Më dhanë edhe rroba për t'u veshur se merre me mend si u kthyem ne pas 16 vjetëve! Dhe unë kam filluar punë dhe kam ndenjur pastaj në shtëpinë e një shoqes sime, ... kam ndenjur të shtëpia e kësaj. Familja ishte akoma në fshat. U hap shkolla, ish-Shkolla e Partisë dhe të dënuarit politik dhe ordiner mësynë atje dhe zunë nga një banesë për të jetuar. Dhe ne jetuam atje. Kemi ndenjur pesë vjet. Dhe atje që një geto e jashtëzakonshme, se kushtet e jetesës jashtëzakonisht të këqija, me banja kolektive⁶⁶

Citim 20: Pjesa tjetër... i gjeti lirimi... i gjeti pak të moshuar, të sëmurë, pa punë. Pjesa më e madhe vuajnë akoma. Nga sëmundjet, vuajnë nga papunësia, se s'punojnë dot. Kanë marrë ndonjë shtëpi, mbijetojnë. Zvarriten, po nuk janë... nuk janë⁶⁷

Keto dy forma veshtirësish (Citim 16-20) janë shembull i padrejtesise me të cilën shtresa e përndjekur po përballlet ende. Pavaresisht veshtiresive afatgjata të përshkruara më sipër, në Shqipëri, ashtu si dhe në vende të tjera, mbi 30 vjet pas ndryshimit të regjimit ende i

⁶⁵ Intervista gojore 25

⁶⁶ Intervista gojore 3

⁶⁷ Intervista gojore 1

kushtohet shume pak vemendje reformave qe lehtesojne rehabilitim e pasojave fizike dhe psikologjike të shkeljes së të drejtave të njeriut⁶⁸.

Tema III: Bashkërendimi i dëmshpërblimit ekonomik me të drejtat e tjera.

Përgjigja e kesaj pyetjeje vjen nga analiza cilesore e përgjigjeve në pyetësorë dhe intervista. Të mbijetuarit e diktaturës shqiptare dhe pasardhësit e tyre renditën forma të ndryshme të dëmshpërblimit në proceset kryesore të drejtësisë (shih tabelën 1). Pikë së pari, ata dhanë një përkufizim të gjerë të dëmshpërblimit, ku përfshiheshin masa ekonomike (p.sh. demshperblimet) dhe njohja e të drejtave (p.sh. pensionet, kthimi i pronës) si dhe rehabilitimi në status të plotë social dhe politik në shoqërinë aktuale. Në rend të dytë vinin reformat ligjore dhe politike, kurse në rend të tretë rikthimi e shumë të drejtave të mohuara gjatë diktaturës. Më tej renditej hetimi dhe ndëshkimi i autorëve të shkeljeve të të drejtave dhe lirive, si dhe zbardhja e së vërtetës. Proceset e tjera përfshinin masa që synojnë pranimin e dëmeve të shkaktuara nga ana e fajtorëve dhe eliminimin e ndikimit të regjimit diktatorial në të tashmen. Së fundi, reflektimi kolektiv dhe mbështetja e komunitetit u konsideruan gjithashtu të rëndësishme.

Tabela 1: *Reformat e drejtësisë tranzitore me te rendesishme per pjesemarrjesit.*

5 llojet e drejtësisë tranzitore me te rendesishme per ju (N=130x5)	Numri i pergjigjeve	% e pergjigjeve
Dëmshpërblimi: Kompensim (ekonomik, edukim, prona, koha ne burg, pension, etj) rehabilitim i te persekutuarve (kthim ne pune, kthim ne qytetin ku jetonin, dinjitet politik, pjesemarrje ne politike, rikthimi ne statusin e meparshme shoqeror dhe re-integrimi ne shoqeri)	172	26.3
Reforma ligjore/te drejtësisë, reforma politike/demokratike, lustracion dhe aplikim te drejte te ligjit.	102	15.6
Rikthimi i te drejtave dhe lirive te fese, levizjes, shtypit, fjales, mendimit, artit, votimit, jetes familjare/bashkimit familjar, lirise dhe jeteses ku te deshirojme.	84	12.8

⁶⁸ Ibid 12.

Denimi dhe hetimi i krimineleve dhe krimeve te komunizmit	81	12.4
Percaktimi i te vertetes (hapja e dosjeve, rishkrimi i historise, dokumentimi ne media dhe perkujtimi i te shkuares)	81	12.4
Kerkimi i faljes dhe pranimi i krimeve	35	4.7
Renia e sistemit komunist dhe heqja e cdo ndikimi te atij sistemi ne shoqerine/ne shtetin sot	31	4.3
Politikanet t'i japin prioritet grupit te persekutuar	28	2.6
Reflektimi mbi krimet e komunizmit/institucionet te kerkojne falje	17	2.1
Mbeshtetja nga shoqeria, komuniteti dhe njeri-tjetri si grup i persekutuar	14	1.5
Te paplotesuar	35	5.3

Pervec dëmshpërblimit per vuajtjet e përshkruara me lart dhe ne temen e pare, dëmshpërblimi duhet te perfshije edhe njohjen e kontributit te plote të të përndjekurve ne diktature si pjesë e dokumentimit te krimeve te komunizmit (Citim 21 dhe 22).

Citim 21: Sot e kesaj dite ka nje irritim ndaj kompensimit financiar qe behet per vitet e burgut. Sepse njerezit nuk e dine qe 70-80 % e veprave industriale e bujqesore jane ndertu me punen e papaguar te te burgosurve politike. E perfytyro edhe aeroporti eshte ndertu me punen e te burgosurve politike. Dhe gfare pune ka qen, e tmerrshme! Dhe ne cfare kushtesh, e tmerrshme! D.m.th. duhet t'i behet e qarte shoqerise shqiptare qe ti i detyrohesh kesaj klase, nuk eshte çeshtje zgjedhje, se ata thone ç'borxh kemi ne te paguajme. Jo, ke borxh! Pra ti ke borxh, ke borxh shume. Çdo gje qe e ke trashegu e ke trashegu nga puna e papaguar e ketyre njerezve, ky eshte vetem demshperblim financiar, moral eshte tjetër⁶⁹.

Citim 22: Nga të burgosurit është tharë kënetat e Tërbufit. Nga të burgosurit është bërë ajo faza rudimentale, fillestare po jo në këtë përmirësim që është bërë gjatë viteve të këtij aeroportit atje ku ju erdhët, "Nënë Tereza". Është bërë aeroporti i

⁶⁹ Intervista gojore 8

Kuçovës, është bërë fabrika e superfosfatit në Laç, fabrika e çimentos në Elbasan, ajo e çimentos në Fushë-Krujë. Është bërë sanatoriumi i Tiranës, janë ndërtuar Pallatet e Shallvareve në Tiranë e sa e sa e sa të tjera, që unë nuk po t'i numëroj të gjitha, se ndoshta nuk del dhe koha që ju keni në dispozicion. Edhe unë edhe ju.... Pra, këta të burgosur që ishin dënuar pa bërë asnjë faj, po vetëm që kishin mendimin ndryshe, nuk e donin atë regjim, këta kanë punuar si skllevërit e kohës së faraonëve, për të bërë ndërtime në vendin tonë, pa para. Edhe që ai mburret që i ndërtoi komunizmi⁷⁰.

Tema IV: Kujt i takon dëmshpërblimi ekonomik?

Nje tjetër rrjedhojë e krimeve të komunizmit është dëmtimi i qellimshëm i familjareve të personave të përndjekur. Kjo do të thote se lista e viktimave ishte shume me e gjere (Citim 23 dhe 24):

Citim 23: Du të trajtoj [një] problem këtu të ... çfarë ndodhte me të burgosurit është më mirë që të intervistosh të burgosurit që kanë qenë në burg. Po çfarë ndodhte me ne jashtë burgut? Jashtë burgut, me familjet e të burgosurve⁷¹.

Familjet e të përndjekurve përfshinin fëmijë, të cilët i vuajnë në afatgjatë pasojat e shkeljeve të lirive dhe të drejtave të prindërve (Citim 24):

Citim 24: Po fëmijet nuk i kemi internuar, tha (gruaja e diktatorit në nje interviste). Po ju i keni internu familjen, nanen, baben, te gjithë. I moret shtepine. Ku do te jetonin fëmijet? Sigurisht fëmijet me vete ne internim. Por ligjerisht te gjithë keta fëmije qe u rriten ne keto kampe internimi nuk figurojne kerkund si te internuar⁷².

⁷⁰ Intervista gojore 10

⁷¹ Intervista gojore 1

⁷² Intervista gojore 6

Ndikimi ndër breza është dokumentuar ne literature: skllaveria⁷³, kolonializimi⁷⁴, holokausti⁷⁵
Per kete arsye, është e rëndësishme që dëmshpërblimi ekonomik t'i takojë të gjithë brezave
që vuajtën dhe ende vuajnë pasojat e shkeljeve të të drejtave dhe lirive të njeriut (Citim 25
dhe 26):

*Citim 25: Qeveria e ka, se ajo e ka në dorë, ajo e ka në dorë që të bëjë. ... Po tani, ti
jepu atyre që janë gjallë. Po shiko, se unë jam mbi 70 vjeç. Tani ti pret të vdes edhe
unë? Edhe unë të mos gëzoj asnjë gjë?! Unë boll e kam që kur më vinë lekët e babait
më dridhet shpirti, se ai vuajti dhe nuk gëzoi absolutisht asnjë gjë. Nuk arriti të
shikonte ... të thuash këtë lloj demokracie që të paktën na u hap goja, se asgjë tjetër
nuk fituam⁷⁶.*

*Citim 26: Me thënë të drejtën, vëllai im, i madhi, që bëri në Spaç, ai ka marrë, ka
marrë. Bile mori këstin e gjashtë te burgut te vet. Ndërsa unë, që më ka vdekur im atë,
që jam rritur rrugëve të [emri I qytetit] që jam rritur pa bukë, që kam parë me sytë e
mi gjëra që kur i kujtoj sot nuk e di më duket të them unë kam qenë ajo që i kam
përballuar, nuk më besohet. Unë nuk kam marrë asnjë lek nga burgu i babait tim. Po
tani edhe unë duhet të marr për babanë tim se e kam ... s'e njoha kurrë⁷⁷.*

Tema V: Kush duhet ta kerkoje dëmshpërblimin ekonomik?

Siç u trajtua me lart, pasojat e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut në diktaturë ndihen
edhe sot, rreth 30 vjet pas ndryshimit të regjimit. Ish të përndjekurit politik, familjarët dhe
pasardhësit e tyre ende vuajnë ne aspektin ekonomik, politik dhe te kapitalit shoqëror.
Pjesemarresit në këtë studim besojne se fuqizimi ekonomik arrihet vetem ne saje te fuqizimit
politik, dhe shoqëror.

⁷³ Graff, Gilda. "The intergenerational trauma of slavery and its aftermath." *The Journal of psychohistory* 41, no. 3 (2014): 181-197.

⁷⁴Ibid 3

⁷⁵ Dashorst, Patricia, Trudy M. Mooren, Rolf J. Kleber, Peter J. de Jong, and Rafaele JC Huntjens. "Intergenerational consequences of the Holocaust on offspring mental health: a systematic review of associated factors and mechanisms." *European journal of psychotraumatology* 10, no. 1 (2019): <https://doi.org/10.1080/20008198.2019.1654065>

⁷⁶ Intervista gojore 24

⁷⁷ Intervista gojore 21

Citim 27: Nga gabimet më të mëdha tonat është pikërisht kur u liruam nga burgu u desh të krijonim një parti. Ne s'kemi përfaqësues në Parlament nga ish-të përndjekurit politik⁷⁸.

Pjese e fuqizimit është edhe dokumentimi i te vertetes dhe edukimi i brezit të ri me historinë e së shkuarës së afërt. Dokumentimi dhe njohja e historisë jo vetëm që do të mundësonte shangien e përsëritjes së gabimeve historike të së shkuarës, por do t'u rikthente dinjitetin ish të përndjekurve dhe gjithë atyre që vuajtën e vuajnë ende pasojat e krimeve komuniste. Po ashtu, kjo do të mundësonte rifitimin e respektit të munguar ndaj tyre (Citim 28 dhe 29):

Citim 28: Pra, shoqëria jonë është formuar në atë mënyrë, nuk mund ta zhbësh. Mirëpo kjo rrezikon të prodhojë një injorancë, jo në kuptimin, por një padije pra të brezit të ri ndaj asaj që ka ndodhur. Dhe kjo përkthehet në përsëritje të gabimeve ose në mosrespekt të tjetrit. Të dhimbjes dhe të sakrificës dhe të vuajtjes së tjetrit⁷⁹.

Ndonese përgjegjësi kryesor për shpagimin e krimeve të së shkuarës është shteti, shoqëria civile dhe komunitetet në përgjithësi mund dhe duhet po ashtu të mbështesin shtresën e përndjekur (Citim 28 dhe 29):

Citim 29: Edhe shoqëria civile që në çdo vend tjetër duhet të bente namin për të drejtat e njeriut, kjo është detyra e shoqërisë civile. Realisht tani kanë filluar të behen pak të gjalle sepse vec me këto gje nuk janë marre, sepse në ishëm dhe të paorientuar, sepse shumë mirë mund ta orientonin këto klase të benin penalizime, të ngrinin gjyqe, të akuzonin në grup, të akuzonin hetuesit qofte dhe brenda ligjeve të shtetit të asaj kohe. ... Pra në një farë mënyre ata që ishin kompetente, ata që kishin njohuri, ata që dinin duhet të merrnin përsiper një mision të kësaj natyre që të bëjnë një lloj drejtesie në këto vend⁸⁰.

⁷⁸ Intervista gojore 19

⁷⁹ Intervista gojore 16

⁸⁰ Intervista gojore 23

Reformat ne drejtesi duhet të synojnë edhe rritjen e kapitalit shoqëror të këtij grupi. Kapitali shoqëror do të mundesonte një mbështetje më të madhe për kërkesën e arritjes së drejtësisë⁸¹.

Diskutim

Dy studimet e paraqitura në këtë kapitull patën për qëllim t'u përgjigjeshin një seri pyetjesh. Pyetja e parë lidhet me shqyrtimin se cilat detyrime/krimet duhet të adresohen nga drejtësia tranzitore (dëmshpërblimi). Analiza e intervistave tregoi se krimet e regjimit komunist ishin të natyrave të ndryshme. Ato kufizuan ose mohuan tërësisht të drejtat civile, politike, ekonomike, shoqërore dhe familjare të personave të përndjekur, familjarëve dhe pasardhësve të tyre gjatë dhe pas rënies së regjimit. Pjesëmarrësit përshkruan në detaje pasojat afatgjata të këtyre krimeve. Pyetja e dytë lidhet me faktin se si lidhet dëmshpërblimi ekonomik me format e tjera të drejtësisë tranzitore. Analiza e intervistave dhe anketave tregoi se dëmshpërblimi ekonomik është shumë i rëndësishëm dhe i nevojshëm për të lehtësuar përballimin e pasojave afatgjata të krimeve. Në fakt, dëmshpërblimi shihet si një nga format kryesore të reformave që duhet të ishin ndërmarrë e ka ende nevojë të ndërmerret. Pasojat e krimeve të komunizmit janë aq të shumëllojshme sa prekin disa breza, qysh nga femijet e lindur në diktaturë, ashtu dhe brezat që lindin sot. Në përgjigje të pyetjes së tretë, të dhënat tregojnë se ish të përndjekurit politik dhe familjarët e tyre trashëgojnë mungesë të kapitalit ekonomik, politik dhe shoqëror. Për këtë arsye, kompensimi ekonomik duhet të përfshijë disa breza. Mungesa e kapitalit ekonomik lidhet ngushtë me dokumentimin dhe njohjen e historisë. Pasojat negative të shkeljes së skajshme të një morie të drejtash i pamundëson shtresës së të përndjekurve politik, familjarëve dhe pasardhësve të tyre të kërkojnë shpërgjimitin e duhur dhe të nevojshëm për padrejtësitë e përjetuara. Në përgjigje të pyetjes së katërt se kush duhet ta kërkojë dëmshpërblimin ekonomik, analiza nxorri në pah se përfshirja e gjithë shoqërisë ashtu si dhe shtetit është e domosdoshme që ky kompensim të kërkohej dhe të arrihej.

Pasojat ekonomike, qofshin ato të drejteperdrejta ose jo, ishin një nga qëllimet kryesore të krimeve të komunizmit. Për këtë arsye, reformat e dëmshpërblimit ekonomik duhet:

⁸¹Van Zomeren, Martijn, Tom Postmes, and Russell Spears. "Toward an integrative social identity model of collective action: a quantitative research synthesis of three socio-psychological perspectives." *Psychological bulletin* 134, no. 4 (2008): 504-535.

- të informohen nga dokumentimi sistematik i krimeve të kryera;
- të informohen nga kendveshtrimet e vetë të përndjekurve politik dhe pasardhësve të tyre;
- të marrin parasysh përçimin e pasojave ndër breza;
- të realizohen në mënyrë të bashkërenduar me format e tjera të drejtësisë tranzitore.

Gjetjet nga këto dy studimet ofrojnë dëshmi të mëtijshme mbi rëndësinë e përfshirjes së këndvështrimeve të mbijetuarve në kuptimin e nevojave të tyre. Këto nevoja duhet të pasqyrohen në reformat që synojnë vendosjen e drejtësisë tranzitore, duke i dhënë kështu përparësi kontekstit vendor^{82 83 84}. Pjesëmarrësit në të dy studimet shprehën hapur dhe qartë idetë e tyre mbi përparësitë për veten, komunitetin dhe gjithë shoqërinë shqiptare në lidhje me drejtësinë tranzitore. Ish të përndjekurit politik dhe pasardhësit e tyre identifikuan strategji të rëndësishme si për të kompensuar shkeljet e të drejtave dhe lirive gjatë komunizmit ashtu dhe për të shmangur konflikte në të ardhmen. Pranimi dhe qëndrueshmëria e strategjive të tilla do të rritej gjithashtu pasi të mbijetuarit bëhen pjesë e identifikimit, zhvillimit dhe zbatimit të RDT-ve që ata i shohin të përshtatshme në kontekstin e tyre. Sjellja e zërave të ish të përndjekurve politik gjithashtu mundëson shpalosjen e versionit të tyre të së vërtetës.

⁸² Ibid 33

⁸³ Ibid 13

⁸⁴ Ibid 23